

PROCESI I PROKURIMIT PUBLIK PËR FURNIZIMIN ME MEDIKAMENTE PËR PARANDALIM GJATË PANDEMISË COVID 19 NË KOMUNËN E KLINËS PËRCILLET ME PLOTË PARREGULLËSI



Zyra e Prokurimit në Klinikë kishte filluar procesin me procedurë të negociuar pa publikim për njoftim për kontratë.



Operatori fitues u zgjedhë KOSOVA MED HEALTHCARE – PRISHTINË, me vlerë 9,855.00 €.

Nga monitorimi i prokurimit janë gjetur:

Ka munguar dokumenti i pranimit të paisjeve, si dhe vendimi nga Këshilli Emergjent Komunal në dosje.

Kompania fituese kishte dërguar dokumentacion të kompanisë disa herë në emra të ndryshëm të përfaqësuesve të kësaj kompanie.

Cilësia e mallit të pranuar si maska dhe tesha shumë përdorimshe nuk është e përafërt me kërkesën e cila ishte bërë në Këshillin Emergjent Komunal.

Maskat të cilat janë marrë janë punuar nga pëlhura e dobët dhe se çmimi i tyre sic ka marrë Komuna me shumicë ishte i njëjtë si për pakicë, po ashtu edhe veshjet shumë përdorimshe nuk kanë qenë të cilësisë së kërkuar.


OJQ ZANA konkludon se u pranua porosia me cilësi të dobët dhe nuk është marrëparasysh ndjeshmëria e situatës, kur është në pyetje mbrotja e personelit mjekësor e teknik të QKMF-së nga Pandemia Covid-19. Këshilli Emergjent Komunal i udhëhequr nga Kryetari i Komunës si drejtuesi i këtij Këshilli nuk duhej t'i pranonte materialet me cilësi më të dobët.

Projekti nuk ka qenë i planifikuar në buxhet të Komunës.


Projekti nuk ka qenë i përfshirë në planin e prokurimit.

Ka patur deklaratë të disponueshmërisë së mjeteve financiare.

Kontrata është siguruar pas kërkesës për qasje në dokumentat zyrtare.



Këshilli Emergjent Komunal duhet të sigurohen për cilësinë e pranimit të mallit, duke përdorur garancionin bankar të Operatorit Ekonomik.



Pranimi i dorëzimit të paisjeve me medikamente duhet të bëhet në mënyrë transparente.